

URDHËR
Nr.434, datë 16.8.2010

**PËR RILICENCIMIN E AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV TË SË DREJTËS
SË AUTORIT NË FUSHËN E MUZIKËS DHE REGJISTRIMEVE MEKANIKE TË SAJ
“ALBAUTOR”**

Duke marrë parasysh propozimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit nr.615, Prot., datë 28.7.2010 për rilicencimin e Agjencisë “ALBAUTOR” për të ushtruar dhe mbrojtur të drejtat e autorëve në fushën e muzikës dhe të gjitha të drejtat e regjistrimeve mekanike të pronësisë artistike

KONSTATOVA:

Se, në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga ligji nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, i ndryshuar është kompetencë e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve miratimi i ridhënies së licencës kësaj Agjencie në fushën e muzikës dhe të gjitha të drejtat e regjistrimeve mekanike të pronësisë artistike.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 124 pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të neneve 108, pika 1 dhe 109, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”,

URDHËROJ:

1. Rilicencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv të së Drejtës së Autorit “ALBAUTOR” në fushën e muzikës dhe të gjitha të drejtat e regjistrimeve mekanike të pronësisë artistike.

2. Afati i licencës është 3 (tre) vjet nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
Ferdinand Xhaferaj

